



Opstina Klokot/Komuna e Kllokot

Në bazë të nenit 43.pikat (43.1,43.2,43.3,43.4,43.5) të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale 03/L-040 ,si dhe statutit të komunës sipas nenit 18.u mbajt seanca e dytë e rregullt e Kuvendit komunal të Kllokotit për vitin 2020,me rendin e ditës të përgaditur. Me atë rast u përpilua si vijon:

PROCESVERBALI NGA SENACA E DYTË E RREGULLT E KUVENDIT KOMUNAL TË KLLOKOTIT PËR VITIN 2020

Seanca e parë e Kuvendit të Komunës e mbajtur me datën 28.02.2020,me fillim në orën 11:00në hapësirat e „Shtëpisë së Kulturës” në Kllokot.

Kryesuesi I Kuvendit të komunës Zarko Dejanovic ka udhëhequr seancën. Afati dhe data e dorëzimit të materijalit për seancë është shpërndarë në afat ligjor tek delegatët për shqyrtim. Kryesuesi në përputhje me ligjin mbi Vetëqeverisjen Lokale dhe Statutin e komunës ka mbajtur seancën e dytë të rregullt të Kuvendit komunal.

Sipas audio incizimit përpilohet ky procesverbal nga seanca e dytë e rregullt e kuvendit dhe me atë rast kryesuesi Zarko Dejanovic theksoi:

- Mirë dita të gjithëve,mirë se keni ardhë në seancën e dytë të rregullt të Kuvendit të Kllokotit. Të nderuar delegatë po e hap senacën e dytë të rregullt të Kuvendit komunal. Para se të filloj dëshiroj t'i përshëndes të gjithë delegatët e pranishëm,drejtorët,përfaqësuesit nga OSBE-ja qytetarët prezent sigurisht edhe kryetarin e komunës. Të nderuar delegatë sin ë të gjitha senacat tjera do të bëj thirrjen e delegatëve në mënyrë që të konstatoj kuorum për punën e kuvendit-pas thirrjes nga ana e kryesuesit të Kuvendit z,Dejanovic u konstatua që ka kuorum për punën e sotme të kuvendit. Të nderuar delegatë sin ë cdo seancë shpresoj që e keni marrë materijalin e duhur për punën e kuvendit andaj dëshiroj të Ju pyes a dëshiron dikush të bëjë ndonjë ndryshim apo plotësim të rendit të ditës së sotme? Për plotësimin e rendit të ditës u lajmërua drejtoresha e administratës.

Milena Marinkovic: Mirë dita të gjithëve, në propozimin e kryetarit kam plotësim të rendit të ditës,një propozim vendim të cilin delegatët e kanë marrë në ndërkohë ,për ndarjen e mjeteve financiare nga buxheti I komunës në vlerë prej 500 eurove ka të bëjë më bblërgjen e dhuratave për rastin e 8 Marsit ditës së gruas.

Kryesuesi : T ë nderuar delegatë e ndërgjuat propozimin e drejtoreshës kush është që ky propozim të hyjë si pikë në rend të ditës? Konstatoj se me 9 vota PËR kemi aprovuar këtë propozim që të hyj si pikë e rendit të ditës. Kush është PËR që të aprovohet rendi I ditës së sotme? Konstatoj se njëzërit kemi aprovuar rendin e ditës së sotme. Tani kalojmë në pikën e parë të rednit të ditës e ajo është:

1. Aprovimi I procesverbalit nga seanca e parë e rregullt e Kuvendit komunal nga viti 2020;
Nëse dikush dëshiron të thotë diçka urdhëroni: pasi që askush nuk dëshiron po e hedh në votim pikën e parë . Kush është për ?

Konstatohet që me shumicën e votave me 10 PËR kemi aprovuar pikën e parë të rendit të ditës.
Kalojmë në pikën e dytë e ajo është:

2. Raporti i Kuvendit komunal të Klllokotit për vitin 2019;

Hidajet Ahmeti : Përshendetje për të gjithë të pranishmit,përsëri kam problem sa i përket specifikacionit të shpenzimeve sipas kategorive ekonomike,sigurisht që i kemi shumat që janë specifikuar ,se si ka ardhur deri te shpenzimi ne duan në detaje ti kemi,si p.sh. Mallëra dhe Shërbime,komunalit nuk janë të specifikuara saktë se si janë shpenzuar paratë publike.

Kryesuesi : I nderuari Hidajet kjo është pika për punën e Kuvendit,a dëshiron të thuash edhe diçka?

Shqiprim Rexhepi u lajmërua për fjalë: Përshëndetje për të gjithë,raporti ma i thjeshtë të cilin po e shof është ky që e kemi,ka vetëm shkronja nuk po shof dicka tjetër kjo është forma ma e thjeshtë ,vetëm që dikush të jap raport,sa më përket mua nuk mund të kuptoj asgjë.

Kryesuesi : Numri i aktiviteteve ,sa vendime i kemi marrë në kuvend,sa akt vendime të gjitha janë të shkruara aty ne i kemi votu ato vendime,41 vendime i keni të gjitha vetëm duhet të lexoni. Raporti është që të kujtoheni se cka kemi punuar vitin e kaluar.

Shqiprimi : Ne mund të shkruajmë numra të ndryshëm këtu por duhet ti kemi dëshmitë.

Kryesuesi : Ky raport ka shkruar në ministrin e pushtetit local edhe ata e dinë se sa vendime i kemi marrë, ne cdo gjë e punojmë në përputhje me ligjin. Ky është vetëm raport,kalojmë në pikën e tretë.

3.Shqyrtimi dhe aprovimi i raportit vjetor financiar nga viti 2019;

Kelmend Rexhepi –zyrtar kryesor financiar e mori fjalën: Përshëndetje ë gjithëve,nuk dua të ju marrë shumë kohë,nuk dua të shkoj me shifra sepse të gjithë e keni materijalin para jush. Këtë raport e kemi dorëzuar në ministrinë e financave,deri më tani nuk e kemi patur asnjë vërejtje e as në vitet e kaluara. Sa i përket kategorive ekonomike që i tha Hidajeti ne këtu i kemi pasqyruar se si i kemi shpenzuar sipas kategorive. Kjo është formë standard për të gjitha komunar dhe për të gjitha organiztata buxhetore në Kosovë. Ne nuk mund t'i ikim kësaj forme sepse nëse ne punojmë sipas ndonjë forme tjetër ministria nuk do të na e pranoj. Nëse keni ndonjë pyetje urdhëroni.

Hidajet Ahmeti : Unë jam i tillë nuk dua të besoj në formë, por në përmbajtje,formaliteti është përgjegjësi ligjore unë e di që ministria nuk mund të jap vërejtje sepse aty ka forma. Ne si delegatë kërkojmë të specifikohen në detaje siç pot hot Kelmendi që kjo është standard,si psh. Komuna e Vitisë raportin gjashtë mujor financiar apo atë vjetor të shpenzuar sipas kategorive ekonomike ata e marrin saktë secilin specifikim. E di që nuk ka asnjë efekt juridik nëse ne e votojmë apo jo,por vetëm është obligim i komunës që raportin ta paraqes para kuvendit. Përfaqësuesit sic është Kuvendi kanë të drejtë të kërkojnë çdo cent i cili është shpenzuar nga ana e komunës.

Kelmendi: Ne asnjëherë nuk thënë që nuk do të bashkëpunojmë me Kuvendin,kemi thënë kujt i intereson nga ana e delegatëve,le të vijnë ose formoni komisionin që të keni qasje ,por që ju asnjher nuk keni ardhur.

Hidajeti : unë nuk kam asgjë personale kundër Kelmendit ne edhe më herët kemi folur lidhje me specifikacionet neve na është premtuar që në raportet tjera do ti specifikojmë .

Shqiprimi : Unë e përkrah mendimin e Hidajetit dhe edhe unë dua të dij shpenzimet që janë bërë jashtë Kosovës kontratat e tjera ,derivatet e naftës,sigurimin e objekteve janë shuma të mëdha.

Kryesuesi : Ky raport financiar ka shkuar në ministri dhe dihet se ku janë shpenzuar mjetet financiare nuk ka asnjë fshehtësi,ndërsa Ju Shqiprim dhe Hidajet mund të shkoni tek Kelmendi dhe të shifni se ku janë shpenzuar mjetet financiare.

Naser Shabani : Përshëndetje për të pranishmit,ne për këtë problem kemi patur diskutime dhe nuk dua ta zgjas shumë, ka qenë auditori i cili ka dhënë vërejtje ne kemi dhënë një rekomandim pasi që jemi antar të kuvendit dhe që mos ti përsërisim ato gabime sepse secili që punon mund edhe të gaboje një veç se e kam lexuar dhe nuk janë kush e di se çfarë shifra të mëdha por që sqarimi duhet të precizohet.

Sasa Mirkovic u paraqit për fjalë: Përshëndetje të pranishmëve,pasi që po bëhet fjalë mbi shpenzimet dhe unë jam aty në kabinetin e kryetarit dhe ne sinqerisht po mundohemi që paratë të shpenzohen për qëllime të drejta aq sa na lejon buxheti këtë më së miri e dijnë Zorani dhe shefi kryesor financiar dhe i tërë ekipi ,dhe se po mundohen që ta bëjnë punën e tyre si dinë dhe si munden. Do të kthehem tash për një 5 vite mrapa e njëjta histori ka qarkulluar se si delegatët në detaje kanë kërkuar,nuk dua të them tani se a kanë qenë delegatë nga SLS-ja apo ndonjë parti tjetër dua të them që ekipi i njëjtë ka punuar në financa. E keni propozimin e mirë nga shefi i financave që është në pajtim me ligjin Ju keni të drejtë të kontrolloni në komunë se qeverija ekzekutive mos ka bërë keqpërdorime ka shpenzuar paratë ,nuk është i dedikuar për të , me siguri të plotë vërtetohet që një mqnryrë profesionale punon kabinetin i kryetarit me financat por që të ju është që të merreni vesh me zyrën e financave që të merrni informata mbi shpenzimin e mjeteve financiare. Që të mos përsëritet në ndonjë seancë tjetër ,ata do të ju pranojnë në zyrë dhe ju do të merrni të gjitha informatat në zyrë.

Hidajet Ahmeti : Nuk është dashur fare të diskutojmë për këtë çështje,kur të jipet një premtim public në kuvend,herën tjetër do të jenë në raport të specifikuar pikë për pikë se ku janë shpenzuar paratë,sikur ne ta kishim marrë ashtu sic e kemi kërkuar sigurisht që sot nuk do të diskutonim ,dikush duhet të përgjigjet këtu se si duhet ,sepse askush nuk po e konteston si raport. Që të ndërlidhem tek dokumentat [publike unë e kam dorëzuar një kërkesë në seancën e kaluar për dy dokumente fjala është për subvencionet dhe transferet për vitin 2019,dhe kam kërkuar projektin e asfaltimit për asfaltimin e një rruge por që ende nuk i kam marrë ato dokumente.

Sasa Mirkovic : Nëse jeni drejtuar me shkrim në ndonjë department ata duhet të bartin përgjegjësinë që nuk l'u kanë përgjigjur. Do të kthehem përsëri tek raporti financiar,ju në qeverisjen e kaluar keni qenë në pushtet ekezkutiv delegatët e kuvendit kanë marrë formë të tilla do të thotë ne nuk mund ta ndrojmë formën të cilën na e dërgon ministria e financave dhe thesri.

4. Propozim vendimi mbi marjen e vendimit të Kuvendit për hartimin e hartave zonale ;

Nurtene Pira: Përshëndetje për të gjithë të pranishmit. Ky propozim vendim do të duhej të aprovohej në vitin 2015,por që nuk është aprovuar dhe askush nuk ka punuar për të,sepse për këtë duhen një shumë e madhe e mjeteve financiare dhe duhet të marrë pjesë një organizatë,kështu që unë e kam një rekomandim nga ana e Ministrisë së Pushtetit Lokal. Ky propozim vendim duhet të aprovohet tani këtë vit,Ju e keni materijalin dhe nëse keni ndonjë propozim lirisht thuane.

Naser Shabani: Unë e duartrokas zonjën për këtë propozim në lidhje me zonën e kadastrale të Kllokotit që unë e kam kexuar tashmë dhe duhet të jetë ashtu siç është, zonja thotë se ajo ka një program për të. Sigurisht si çdo komunë edhe komuna e jonë duhet të ketë hartën zonale. Kur bëhet fjalë për këtë, ne

delegatët e Asamblesë dëshirojmë të kemi një pasqyrë të këtij programi, në mënyrë që të dimë se ku është zona jonë.

Nurtene: Zona kadastrale në vetvete do të ketë një plan të detajuar për secilën ngastër, natyrisht, dhe është më e lehtë për përdoruesin që ta adresojë atë kur ta kërkojë është më e lehtë se si dhe ku mund ta kthej atë, por kjo është një shumë e madhe për atë program, për këtë është kërkuar mbështetje financiare është e nevojshme të dërgojmë një propozim vendim në ministri. E vetmja është komuna jonë që nuk ka hartë, kemi por nga viti 2012 deri në vitin 2017. Ne po punojmë sipas asaj harte.

Hidajet: Për pikën gjashtë, shuma është cituar, a keni bërë ndonjë analizë se sa saktë do të ketë vlerë?

Nurtene: Nëse sot miratohet ky propozim atëherë në senacën e radhës do ta keni programin e punës. Hidajeti kërkoi të dijë se sa do të kushtojë e dijmë se komuna nuk ka kapacitet financiar e as ekspert, do të ishte mirë që të kërkojmë ndonjë organizatë jo qeveritare që do të na ofronte përkrahje financiare.

Mirkovic: Ne i kemi këto harta, ato janë bërë në vitin 2012, gjë që është shumë e rëndësishme për komunën, sepse vetëm komuna jonë nuk ka hartë, nuk janë burime të vogla financiare, e di që LOGOS ishte përfshirë me komunën e Vitinës për hartimin e planit të punës ka qenë i kyqur edhe UNDP-ja këto janë të gjitha organizata të forta që financojnë projekte të tilla, unë jam dakord me Hidajet që ne nuk kemi kapacitete as profesionale, as financiare.

Kryesuesi : E ndëgjuat sqarimin kush është për aprovimin e kësaj pike? Konsatoj që me 11 vota PËR u aprovua pika e katër e rendit të ditës.

5. Informacion mbi raportin për punën e shërbimeve publike dhe komunale për vitin 2019;

Milena: Të nderuar delegatë , e keni marrë raportin e shërbimeve publike,sa i përket vërejtjeve dhe pyetjeve urdhëroni.

Hidajeti: Në këtë raport janë përmendur përfaqësuesit e fshatrave dhe kanë thënë se janë pastruar varrezat së bashku,por që në Mogillë kjo gjë nuk qëndron. Ne si organizatë multietnike vullnetarisht jeni organizuar dhe kemi pastruar varrezat dhe rrugët,ky është një problem që institucioni nuk ka ndërmarrë asgjë të paktën të keni përkrahje morale nga ana e institucionit.

Petkovic: Përshëndetje të gjithëve, kemi dëgjuar drejtorin në lidhje me shërbimet publike, i respektoj të gjitha kapacitetet, por për një vit e më shumë flas për problemin në Kllokot kam një premtim si nga ushtruesi i detyrës ashtu edhe nga drejtori i financave që kjo do të kryhet, te shkolla kanali nuk është zgjidhur më është premtuar se ujërat e zeza do të zgjidhen dhe nuk janë zgjidhur akoma. Këtu po vini në kuvend po e kapërceni kanalin duhet të ndërtohen një urë ,askush nuk po kujtohet që ta zgjidh këtë gjë,ai ujë po qëndron në kanal kurr nuk po rregullohet. Unë po Jul us që të jeni më serioz nëse duhen mjete ne do të votojmë. Kllokoti duhet të pastrohet të rregullohet ,nga bari nuk mund të kalohet. Në vetë qendrën e fshatit ekziston shakta e lartë 24 cm. Thelbi i gjithë historisë është që të bëheni serioz dhe të rregullohet selia e vetë komunës,kjo është një pasqyrë e jona dhe e juaja.

Milena: Zotëri Petkovic ka të drejtë për të gjitha që i tha, Unë do të doja të shpjegoja të gjitha këto tani. Sa i përket ujërave të zeza kemi pasur një takim me kryetarin dhe nënkryetarin kemi vendosur pikat më kritike në Kllokot dhe jemi në pritje të ftesës së kompanisë për të dalë në vend për të bërë një vlerësim për të alokuar fonde për zgjidhjen e këtij problemi. Sa për urën këtu që ju thatë, unë do t'ju kërkoja të paraqisni një kërkesë përmes arkivit.Sa i përket shahtës ajo është rregulluar si e tillë përkohësisht e ajo

pot ë njëjtën ditë është shkatërruar. E di që gjëja më e lehtë për të bërë është vetëm të kritikosh, asnjë lavdërim nuk ka arritur ndonjëherë për depatanin tim. Sa i përket Klokot, unë mendoj se ka një grup njerëzish që janë duke bërë disa gjëra me qëllim që të sjellin gjithë fajin në komunë. Unë përmes njoftimit public kam informuar se çka lejohet e çka nuk lejohet të hidhen në kontejnerë, po ashtu edhe puntorët e mi disa herë i kanë paralajmëruar shfrytëzuesit e atyre kontejnerëve, megjithëatë saktësisht para shkollës në Klokot dikush qëllimisht para kontenjerit e ka hedhur dhe shperndarë mbeturinat ,rreth rrugës dhe para shkollës kjo gjë është bërë qëllimisht , unë kam marrë vendim që ti heq ata kontenjer, kurse kjo që është hedhur qëllimisht pranë kontenjerit do ta zgjidhim përmes rrugës inspektuese.

Petkovic: Sa për fshatrat e tjerë, unë mund t'ju përgëzoj, por kam folur për Klokot për një kohë të gjatë dhe ju nuk keni zgjidhur asnjë problem. Ju nuk keni nevojë për fonde për të pastruar kanalin e lumit tek shkolla Shën Sava në Klokot është një kanal ku uji qëndron, fëmijët marrin frymë duhet të jetë ujë i pastër që do të shkojnë me rrjedhën.

Shqiprim: Desha ta informoj drejtoreshëm e administratës ajo ndoshta është në dijeni, në Mogillë tek shtëpia e fundin deri tek Ura e Dilit mungojnë shahtat, banorët na kanë lajmëruar. drejtoresha po thotë që po prët organizatën që të shoh se sa do të kushtoj për fshatin Klokot atëherë le të shifet edhe për fshatin Mogillë sa do të kushtoj.

6. Ndarja e mjeteve financiare për 8 mars;

Kryesuesi : Mendoj që këtu nuk ka cka dilemma duhet të blihen dhuratat për ditën e gruas.

Stojilkovic : unë e kam një vërejtje 500 euro janë pak për ato dhurata.

Hidajeti : e di që vitin e kaluar ka qenë një problem për shkak të dhuratave dhe festimit të 8 marsit do të ishte mirë që këtu të diskutojmë se në cilin restorant do të shkojnë, unë vetëm kam marrë disa vërejtje nga disa njerëz.

Kryesuesi : këtu nuk bëhet fjalë për restorant por për ndarjen e mjeteve ,tani po e hedh në votim pikën e 6 të rendit të ditës. Konstatoj që me 9 vota kemi aprovuar pikën e gjashtë.

7. Të ndryshme:

Kryesuesi i: Jam i obliguar të ju njoftoj që të drejtoheni tek shefi i personelit Skender Hoda që të merrni formularët për agjensionin e korrupsionit dhe për 15 ditë kjo të kryhet.

Po e mbyll senacnë e dytë të rregullt të Kuvendit komunal Klokot.

Datë: 28.02.2020

Kryesuesi i Kuvendit Komunal



Zarko Dejanovic/